

PSH.nr.957/20

967/20

994/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE: “REXHA” Shpk-Prishtinë, dhe OE: “PE-VLA-KU” Shpk-Prishtinë si dhe ankesa e OE “RAF II” Shpk-Rahovec, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i operatorve ekonomik: “Fidola” & “Nartel Exin”Shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit” me nr.prokurimi 616-19-9686-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –“KK Prishtinë”, më datën: 15.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “REXHA” Shpk-Prishtinë, dhe OE: “PE-VLA-KU” Shpk-Prishtinë si dhe ankesa e OE “RAF II” Shpk-Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Tregu i ri i qytetit” me nr. prokurimi 616-19-9686-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –“KK Prishtinë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit” me nr.prokurimi 616-19-9686-5-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –“KK Prishtinë” dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “REXHA” Shpk-Prishtinë, OE “PE-VLA-KU” Shpk-Prishtinë, si dhe ankesa e OE “RAF II” Shpk-Rahovec, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “REXHA” Shpk-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 17.11.2020 me nr. 957/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Tregu i ri i qytetit” me nr.prokurimi 616-19-9686-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –“KK Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 10, 27, 52, 59, 60, 61, 65, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Vendimi i OSHP-së, si dhe Vendimi i juaj për aprovim të kërkesës tonë.

Operatori ekonomik ankues OE “PE-VLA-KU” Shpk-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 18.11.2020 me nr. 967/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Tregu i ri i qytetit” me nr. prokurimi 616-19-9686-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –“KK Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 27, 28, 51, 56, 59, 68, 69, 70, 71 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 2, 26, 27, 39.8 dhe 41 të RRUOPP-së.

Operatori ekonomik ankues “RAF II” Shpk-Rahovec, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.11.2020 me nr. 994/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit” me nr.prokurimi 616-19-9686-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –“KK Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 64 dhe 69 të Ligjit për

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 03.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "REXHA" SHPK

Përgjigje në pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE "Rexha" Shpk, se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesën mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të parashtruar në dosje të tenderit ku është kërkuar qarkullimi financiar për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 10,000,000.00 € (në rast konzorciumi lideri duhet ti plotësoj 60 % të kërkesës),që sipas OE ankues dëshmitë e ofruara e përmbushin vlerën e kërkuar, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ky pretendim është trajtuar edhe në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020 në të cilin është rekomanduar që AK të kërkoj sqarime lidhur me qarkullimin financiar. OE ankues "Rexha" Shpk ka dorëzuar deklaratën e qarkullimit financiar të ATK-së për vitin 2017 në vlerë prej 1,764,217.31 €,deklaratën e ATK-së për vitin 2018 në vlerë prej 1,036,771.63 ,ndërsa për vitin 2019 ka dorëzuar një letër konfirmim të bankës Raiffesien Bank sipas të cilës qarkullimi i OE "Rexha" Shpk për vitin 2019 ka qenë 2,623,087.23 €.Gjithashtu ka dorëzuar edhe një konfirmim të bankës TEB sipas të cilës ka pasur një qarkullim 1,037,438.00 €.

Eksperti shqyrtues konstaton se dëshmitë e ofruara nga OE ankues bazuar edhe në kërkesën për sqarime nga AK e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 2

Sa i përket pretendimit tjetër të OE "Rexha" Shpk, se AK ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se në paramasë të objektit 3, pozicioni 9.1 është përsëritur dy herë, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit ky ndryshim duhet të trajtohet si gabim aritmetik që nuk kalon vlerën prej 2% të totalit të ofertës.

Vlen të theksohet se OE ankues në njërin pozicion ka paraqitur sasi të që i ka parapare AK-ja, ndërsa në pozicionin vijues ka paraqitur një sasi të gabuar dhe AK është dashur të kërkoj sqarim apo edhe te mos

kërkohet fare sqarim, por vetëm të zbritet pozicioni me gabime dhe për këtë të njoftohet tenderuesi. Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në pretendimin 3

Lidhur me pretendimin e OE "Rexha" Shpk, se oferta e tyre është eliminuar me arsyetimin se nuk ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontrata të ngjashme siç është kërkuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, duhet të i sqaroj kontratat e OE ankues se a e plotësojnë këtë kërkesë të AK-së.

Me datë 25.09.2020, AK përmes letrës standarde për sqarimin e tenderit nga OE "Rexha" Shpk ka kërkuar sqarime lidhur me atë se në çka bazon pretendimin e tyre për eliminim pa të drejtë lidhur me referencat të cilat janë trajtuar nga AK sipas kërkesave të dosjes së tenderit. OE ankues "Rexha" Shpk në përgjigjen e tij ka dorëzuar një listë të kontratave të realizuara së bashku me referencat për realizimin e këtyre kontratave që tejkalojnë vlerën e kërkuar prej 4,500,000.00 €. Në pyetjen e një OE drejtuar AK-së për sqarime "Pasi që edhe renovimet e objekteve hyjnë në kategorinë e ndërtimit të lartë, atëherë a mund të na tregoni se a njihen si referenca eksperiencia e punës në renovimin e objekteve të lartë?", AK me datë 31.01.2020 jep këtë përgjigje/sqarim "Nuk pranohen eksperiencia e punës së renovimeve, por pranohen referencat e ndërtimeve të larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit të nenit 3 paragrafi 1.10 të ligjit për ndërtim NR.04 L-110).

Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm pasi që Autoriteti Kontraktues është dashur të respektoj sqarimin e dhënë me datën 31.01.2020, sipas të cilit ka sqaruar se pranohen referencat për ndërtime të reja sipas nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-110. Ky nen nuk përcakton ndërtime të larta apo të ulëta por përcakton si vijon: Ndërtimi i ri është ndërtimi që kryhet në një parcele toke ku nuk ka ndërtim ose e zëvendëson plotësisht ndërtimin ekzistues. Bazuar në këtë OE-ik "Rexha" Shpk është dashur të pranohen referencat e ofruara si vijon: "Ndërtimi i objektit të shkollës në Arbëri – faza e dytë", "Ndërtimi i Bulevardit mbi Kurriz", "Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria", "Sanimi dyshemesë urbane në sheshin Adem Jashari" dhe shumë referenca tjera që paraqesin ndërtim të ri sipas Ligjit nr.04/L-110. Pra në këtë mënyrë AK duke mos respektuar sqarimin e vetë ka trajtuar pa të drejtë këtë tenderues si të pa përgjegjshëm. Ky trajtim është edhe më i pa kuptueshëm për faktin se në aktivitetin e AK-së janë të përfshira të gjitha llojet e punimeve që janë të përfshira edhe në kontratat e ofruara nga ky tenderues. OE ankues ka dëshmuar shumë kontrata të projekteve investive/kapitale që njihen si kontrata pune që kanë të bëjnë me ndërtim të ri dhe pothuaj të gjitha këto kontrata përmbajnë lloje/pozicione të punimeve që janë paraparë të kryhen në këtë aktivitet të prokurimit, andaj për ekspertin shqyrtues të gjitha këto kontrata dhe referenca duhet të pranohen nga AK. Konsideroj që pretendimi i OE ankues është i

bazuar dhe dëshmitë e ofruara nga OE ankues për kontrata dhe referenca e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 4.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues “Rexha” Shpk, se autoriteti kontraktues ka pranuar referencën e OE të rekomanduar për kontratë lidhur me projektin “Ndërtimi i spitalit pediatrik dhe Kirurgjisë Pediatrike, QKU” edhe pse kjo referencë nuk është nga AK shtetror (QKUK) por është nga një OE privat, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20, citoj një pjesë të vendimit, “Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se projektin në fjalë, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka të kontraktuar nga QKUK por ka të kontraktuar nga një kompani private. Shprehja apo përkufizimi “Autoritet kontraktues” nuk nënkupton vetëm autoritetet publike apo shtetërore. Sipas nenit 4 pika 1.14 të LPP-së Autoritet kontraktues është edhe kompania private. Prandaj çdo projekt i kryer nga një OE me një kompani private për të cilin merr edhe referencën e njëjta referencë është e pranueshme sipas ligjit të prokurimit. Edhe në rastin konkret referenca e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për projektin e kryer në ndërtimin e spitalit në fjalë është e pranueshme dhe si e tillë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Në kuptim të kësaj që u sqarua, ky pretendim ankimor është i pa bazuar”.

Eksperti shqyrtues sqaron se ka dhënë një përgjigje ndaj këtij pretendimi në një kontest tjetër të parashtruar nga OE “Pe-vla-ku” citoj, “Sa i përket pretendimit të OE ankues se referenca e lëshuar nga “Mabetex Group” për OE e rekomanduar për kontratë për punët e kryera në Spitalin Pediatrik dhe Kirurgjisë Pediatrike në QKUK nuk është cekuar vlera e çmimit të ndërtimit të projektit, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave ka prezantuar që ky projekt deri me 31.12.2019 është realizuar në shumën prej 6,649,980.28 €, ndërsa pjesa e mbetur është në proces. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar kontratë me “Mabetex Group” që mund të dëshmohej pjesëmarrja e OE “Fidola” në këtë projekt. Gjithashtu nuk ka të bashkangjitur ndonjë dëshmi të realizimit të punimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues, në këtë rast QKUK -së, sepse ky projekt akoma nuk është i përfunduar. AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë sqarime/dëshmi shtesë për kontratën me “Mabetex Group”apo edhe ndonjë dëshmi të AK,”QKUK” lidhur me realizimin e punimeve në këtë projekt”. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 5

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë certifikatat për ISO STANDARDE nuk i ka ofruar të noterizuara siç është kërkuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues

sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit është kërkuar që AK gjatë rivlerësimit të kërkoj konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së informata shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë më saktësisht certifikatat ashtu siç ka qenë kërkesë e vet AK-së. Konform vendimit të OSHP-së, AK me datë 25.09.2020 përmes "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit" ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzoj certifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Me datë 28.09.2020 OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikatat e noterizuara të cilat janë noterizuar me datë 20.04.2020 (pas datës së dorëzimit të tenderëve). Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 6

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka shpërblyer me kontratë OE i cili nuk ka dorëzuar dëshmitë për pajisjet siç është kërkuar në dosje të tenderit, konkretisht nuk ka dorëzuar listën e pajisjeve dhe dëshminë për vinç dhe sipas OE ankues kjo ofertë duhej të shpallej e papërgjegjshme, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar pasi që tenderuesi i rekomanduar nga AK-ja nuk ka dorëzuar listë të pajisjeve, por vetëm dëshmi për disa pajisje dhe nuk ka dorëzuar dëshmi për pajisjen vinç. Pasi që për këtë pajisje nuk është ofruar asnjë dëshmi, AK-ja ka kërkuar plotësim për këtë pajisje e cila është ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë. AK konform nenit 72 të LPP-së dhe nenit 39.8 të RRUOPP-së duhet të ketë kujdes për sqarimet apo dokumentet që kërkon sepse kjo pajisje nuk ka qenë në listën e pajisjeve. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 7

Sa i përket pretendimit të OE ankues se Inxhinieri i Elektroteknikës-drejtimi energjetikë i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse inxhinieri është i diplomuar me datë 08.12.2015 dhe nuk plotëson përvojën prej 5 vitesh siç është kërkuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë dëshmi për inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku 2 kontrata të natyrës së ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me CV, Diplomë, Kontratë të punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).

Eksperti shqyrtues sqaron se fillimisht OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një diplomë të z. Behar Zeqiri, i dipl në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 23.11.2015 si Master i

shkencave të Inxhinierisë elektrike, që bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit nuk e plotëson përvojën prej 5 vitesh.

Pas kërkesës së AK-së për sqarim OE i rekomanduar ka dorëzuar një tjetër diplomë për z.Behar Zeqiri, i dipl. në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 22.03.2012 si Bachelor i shkencave të Inxhinierisë elektrike, që sipas ekspertit shqyrtues kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë inxhinier i diplomuar i elektroteknikës dhe sipas kësaj dëshmie z.Behar Zeqiri është bachelor dhe nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Në vendimin e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE ankues “Rexha” Shpk ky pretendim është trajtuar si devijim i vogël, që për ekspertin shqyrtues AK nuk ka dhënë asnjë argument se çka nënkupton me devijim të vogël kur kërkesa e AK-së ka qenë decidive inxhinieri i diplomuar i elektroteknikës duhet të ketë 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 8

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar deklaratat për listën e punëtorëve të punësuar konform dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të ketë mesataren e punëtorëve të punësuar minimum 100 punëtor për vitin 2017,2018 dhe 2019,eksperti shqyrtues sqaron se konzorciumi “OE “Fidola” & “Nartel Exin” Shpk ka dorëzuar listat për të dy anëtarët e konzorciumit. OE “Fidola” ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së për tri vitet, ndërsa anëtari tjetër i konzorciumit “Nartel Exin” Shpk ka dorëzuar deklaratat e listave të punëtorëve të vulosura për tri vitet dhe sipas ekspertit shqyrtues deklaratat e dorëzuara për listat e punëtorëve të punësuar janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse në dosje është kërkuar deklaratë dhe nuk është specifikuar që duhet të jetën vetëm dëshmia e ATK-së. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “PE-VLA-KU” SHPK.

Përgjigje në pretendimin 1

Lidhur me pretendimin e OE “Pe-vla-ku” Shpk, se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka rekomanduar për kontratë përsëri ofertën e grupit të OE “Fidola” & “Nartel Exin” Shpk edhe pse marrëveshja e konzorciumit e dorëzuar nga grupi i OE nuk është e kompletuar dhe mungojnë të dhënat e tenderit, si dhe deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit “Nartel Exin” Shpk është pa datë, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se marrëveshja e konzorciumit të grupit të OE “Fidola” & “Nartel Exin” Shpk është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe në fund të marrëveshjes të dy anëtarët e konzorciumit kanë dorëzuar autorizimet e nënshkruara dhe të vulosura ku është specifikuar edhe nr. i prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit “Nartel Exin” Shpk është pa datë, për ekspertin shqyrtues ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse deklarata nën betim e dorëzuar nga anëtari i konzorciumit “Nartel Exin” Shpk është e vulosur dhe e nënshkruar dhe i drejtohet Autoritetit Kontraktues “Komuna e Prishtinës” dhe mungesa e datës nuk paraqet ndonjë shkelje domethënëse. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar deklarate të specifikacioneve teknike konform nenit 28 të LPP-së, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse në dosje të tenderit nuk është kërkuar deklarata e specifikacioneve teknike.

Përgjigje në pretendimin 2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të gjitha certifikatat ISO siç janë kërkuar në dosje të tenderit dhe sipas OE ankues edhe pas kërkesës për sqarim nga AK, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar certifikatat OHSAS 18001 2007, ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar edhe në vendimin e panelit PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020.

Konform vendimit të OSHP-së, AK me datë 25.09.2020 përmes “Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit” ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzoj certifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Me datë 28.09.2020 OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikatat e noterizuara të cilat janë noterizuar me datë 20.04.2020 (pas dorëzimit të tenderëve).

Sa i përket pretendimit të OE ankues se mungojnë certifikatat OHSAS 18001 2007, ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012, eksperti shqyrtues sqaron se dy certifikatat ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012 janë larguar si kërkesa të dosjes së tenderit në “NJOFTIM PËR INFORMATA SHITESË ose PËRMIRËSIM I GABIMIT”, ndërsa për certifikatën OHSAS 18001 2007 OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatën ISO 45001-20018 më të avancuar e cila është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 3

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën e gjendjes ekonomike dhe financiare të dosjes së tenderit ku është kërkuar që qarkullimi financiar për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 10,000,000.00 € (në rast konzorciumi lideri duhet ti plotësoj 60 % të kërkesës), eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE i rekomanduar për kontratë, konkretisht lideri i konzorciumit “Fidola “ ka dorëzuar deklaratën e qarkullimit financiar të ATK-së për vitin 2017 në vlerë prej 575,240.56 €, deklaratën e ATK-së për vitin

2018 në vlerë prej 1,287,630.13 €,ndërsa për vitin 2019 ka dorëzuar një deklaratë të bankës Raiffesien Bank sipas të cilës qarkullimi i OE "Fidola"për vitin 2019 ka qenë 4,417,286.86 €.Ndërsa për anëtarin tjetër të konzerciumit "Nartel Exin"Shpk ka dorëzuar deklaratën e ATK-së për vitin 2017 në vlerë 1,841,999.70 €,për vitin 2018 vlerën prej 1,647,393.61 €,ndërsa për vitin 2019 kanë dorëzuar një pasqyrë të të ardhurave të "Nartel Exin"Shpk me shumën hyrëse për vitin 2019 në vlerë prej 1,456,295.74 €.

Eksperti shqyrtues konstaton se dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë bazuar edhe në kërkesën për sqarime nga ana e AK-së e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin 4

Sa i përket pretendimit të OE ankues se Inxhinieri i Makinerisë i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është konform dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë një inxhinier të diplomuar të makinerisë (termoenergjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata të natyrës se ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me diplomë, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, referenca per Inxhinier i dip. i makinerise (termoenergjetike).

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar diplomën e z. Aziz Llugini i diplomuar në Fakultetin Teknik të Prishtinës në vitin 1980.

Eksperti shqyrtues sqaron se dokumentet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë e plotësojnë këtë kërkesë të dosjes së tenderit sepse Fakulteti Teknik në kohën kur ka diplomuar z Aziz Llugini nuk ka qenë i ndarë në drejtime, por drejtimi i Makinerisë i ka përfshirë edhe drejtimet tjera.

Sa i përket pretendimit se OE të rekomanduar për kontratë i mungon kontrata për inxhinierin e hidroteknikës, eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar diplomën dhe kontratën e punës për inxhinierin e Hidroteknikës z.Bujar Gashi, andaj ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin 5

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme duke potencuar disa referenca të cilat sipas OE ankues nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e kontratave të realizuara konform aneksit 7 të dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se referenca e lëshuar nga "Mabetex Group" për OE e rekomanduar për kontratë për punët e kryera në Spitalin Pediatrik dhe Kirurgji Pediatrike në QKUK nuk është cekuar vlera e çmimit të ndërtimit të projektit, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave ka prezantuar që ky projekt deri me 31.12.2019 është realizuar në shumën prej 6,649,980.28 €, ndërsa pjesa e mbetur është në proces. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar kontratë me "Mabetex Group" që mund të dëshmohej pjesëmarrja e OE "Fidola" në këtë projekt. Gjithashtu, nuk ka të bashkangjitur ndonjë dëshmi të realizimit të punimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues, në këtë rast QKUK -së, sepse ky projekt akoma nuk është i përfunduar.

AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë sqarime/dëshmi shtesë për kontratën me "Mabetex Group" apo edhe ndonjë dëshmi të AK-së "QKUK" lidhur me realizimin e punimeve në këtë projekt.

Gjithashtu edhe pretendimi tjetër së referenca e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë për "Ndërtimin e fabrikës së gazit mjekësor dhe industrial" e lëshuar nga OE "Medica" nuk ka të cekur vlerën e projektit për ekspertin shqyrtues është i pranueshëm sepse referenca nuk ka të cekur vlerën e projektit. Meqenëse nuk ka vlerë të cekur në referencë, AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj sqarime/dëshmi nga OE i rekomanduar që të dorëzoj kontratën me OE "Medica".

Lidhur me referencën e lëshuar nga Kompania Dugagjini për OE të rekomanduar për kontratë për objektin afaristo banimor ,blloku A1,Lakërishte, që sipas OE ankues në këtë reference thuhet se punimet kanë filluar në nëntor 2015 dhe kanë përfunduar në dhjetor 2018, ndërsa referenca është lëshuar në prill të vitit 2017,eksperti shqyrtues sqaron se në reference thuhet se punët do të përfundojnë në dhjetor 2018 bazuar në kontratë dhe jo kanë përfunduar. Gjithsesi AK është dashur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë, kontratën me OE "Dugagjini Kompani" dhe ndonjë dëshmi të realizimit të këtij projekti siç është raporti i përfundimit i certifikuar nga dhënësi i lejes së ndërtimit në këtë rast Kuvendi Komunal.

Gjithashtu edhe pretendimi tjetër për referencën lidhur me objektin afaristo banimor Trade Center Prishtina, që sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë i ka lëshuar reference vetë vetes, sepse në këtë projekt është në konzorcium me "Agro Trade", eksperti shqyrtues në bazë të dëshmisë nuk mund ta konstatoj që ka qenë konzorcium por AK ka mundur të kërkoj kontratën nga OE "Fidola" me "Agro Trade".Gjithashtu edhe për këtë projekt nuk ka ndonjë raport të certifikimit të punimeve për këtë objekt banesor nga dhënësi i lejes së ndërtimit në këtë rast Kuvendi Komunal. Edhe në këtë reference nuk ka vlerë të cekur se sa është vlera e përfunduar e punimeve.

Eksperti shqyrtues konstaton se referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar që lideri duhet ti plotësoj 60% të referencave për kontratat e realizuara (4,500,000.00 €),sepse referencat nuk përmbajnë vlera të realizimit të punimeve. Për shkak se shumica e referencave janë më OE privat, AK konform nenit 72 të LPP-së është dashur të

kërkoj sqarime/dëshmi shtesë lidhur me kontratat dhe referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 6

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar listën e makinerive siç është kërkuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi lidhur me makineritë është pak a shumë i ngjashëm dhe është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20, citoj një pjesë të vendimit “Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje të tenderit për këtë pikë nuk ka qenë decidivisht që pajisjet, respektivisht kamionët duhet të janë të regjistruar. Por për pajisje janë kërkuar dëshmi si deklarata unike doganore ose kontrata për faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar si dëshmi librezat e kamionëve si dëshmi që i posedojnë këta kamion. Regjistrimi i automjetit mundet të bëhet varësisht prej nevojave të kompanisë. I duhet një kamion i tillë për transport apo nuk i duhet. E rëndësishëm për këtë pikë të dosjes së tenderit është që OE ti posedojnë këto pajisje, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar”. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin 7

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar deklaratat për listën e punëtorëve të punësuar konform dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të ketë mesataren e punëtorëve të punësuar minimum 100 punëtor për vitin 2017, 2018 dhe 2019, eksperti shqyrtues sqaron se konzorciumi “OE “Fidola” & “Nartel Exin” Shpk ka dorëzuar listat për të dy anëtarët e konzorciumit. OE “Fidola” ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së për tri vitet, ndërsa anëtari tjetër i konzorciumit “Nartel Exin” Shpk ka dorëzuar deklaratat e listave të punëtorëve të vulosura për tri vitet dhe sipas ekspertit shqyrtues deklaratat e dorëzuara për listat e punëtorëve të punësuar janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse në dosje është kërkuar deklarata dhe nuk është specifikuar që duhet të jetëm vetëm nga dëshmia e ATK-së. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin 8

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar marrëveshjet për gurëthyes dhe beton të cilat nuk janë të nënshkruara dhe vulosura, eksperti shqyrtues se ky pretendim është pranuar edhe nga AK në vendimin e tyre ndaj kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga OE ankues. Eksperti shqyrtues sqaron se të dy marrëveshjet për gurëthyes dhe beton të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë janë të nënshkruara dhe vulosura nga ana e furnitorit ku janë të bashkangjitura

edhe “Lejet për aktivitete të veqanta “(Liçencat) për të dy furnitorët, ndërsa me kërkesë të AK-së, marrëveshjet janë të nënshkruara edhe nga blerësi në këtë rast nga OE “Fidola” Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “RAF II” SHPK

Përgjigje në pretendimin 1

Sa i përket pretendimit të OE ankues “Raf II” Shpk, se Inxhinieri i Elektroteknikës-drejtimi energjetikë i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse inxhinieri është i diplomuar me datë 08.10.2015 dhe nuk plotëson përvojën prej 5 vitesh siç është kërkuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojë dëshmi për inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku 2 kontrata të natyrës së ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me CV, Diplomë, Kontratë të punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).

Eksperti shqyrtues sqaron se fillimisht OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një diplomë të z.Behar Zeqiri, i dipl në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 23.11.2015 si Master i shkencave të Inxhinierisë elektrike, që bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit nuk e plotëson përvojën prej 5 vitesh.

Pas kërkesës së AK-së për sqarim, OE i rekomanduar ka dorëzuar një tjetër diplomë për z.Behar Zeqiri i dipl në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 22.03.2012 si Bachelor i shkencave të Inxhinierisë elektrike, qe sipas ekspertit shqyrtues kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë inxhinier i diplomuar i elektroteknikës dhe sipas kësaj dëshmie z.Behar Zeqiri është bachelor dhe nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Në vendimin e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga një OE, ky pretendim është trajtuar si devijim i vogël, që për ekspertin shqyrtues AK nuk ka dhënë asnjë argument se çka nënkupton me devijim të vogël kur kërkesa e AK-së ka qenë decideve inxhinieri i diplomuar i elektroteknikës duhet të ketë 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të gjitha certifikatat ISO siç janë kërkuar në dosje të tenderit dhe sipas OE ankues, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar certifikatat OHSAS 18001 2007,ISO 27001 2013,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar edhe ne vendimin e panelit PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020.

Konform vendimit të OSHP-së, AK me datë 25.09.2020 përmes “Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit” ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzoj certifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit. Me datë 28.09.2020 OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikatat e noterizuara të cilat janë noterizuar me datë 20.04.2020 (pas datës së dorëzimit të tenderit).

Sa i përket pretendimit të OE ankues se mungojnë certifikatat OHSAS 18001 2007 dhe ISO 27001 2013, eksperti shqyrtues sqaron se certifikata ISO 27001 2013 është larguar si kërkesë e dosjes së tenderit në “NJOFTIM PËR INFORMATA SHITESË ose PËRMIRËSIM I GABIMIT”, ndërsa për certifikatën OHSAS 18001 2007 OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatën ISO 45001-20018 më të avancuar e cila është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin 3

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar listën e makinerive siç është kërkuar në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues se pretendimi lidhur me makineritë është pak a shumë i ngjashëm dhe është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20, citoj një pjesë të vendimit “Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje të tenderit për këtë pikë nuk ka qenë decidivisht që pajisjet, respektivisht kamionët duhet të janë të regjistruar. Por për pajisje janë kërkuar dëshmi si deklarata unike doganore ose kontrata për faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar si dëshmi librezat e kamionëve si dëshmi që i posedojnë këta kamion. Regjistrimi i automjetit mundet të bëhet varësisht prej nevojave të kompanisë. I duhet një kamion i tillë për transport apo nuk i duhet. E rëndësishëm për këtë pikë të dosjes së tenderit është që OE ti posedojnë këto pajisje, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar”. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka rivlerësuar tenderët konform dispozitave ligjore dhe kërkesave të dosjes së tenderit si dhe vendimit të OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020, andaj rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit AK të respektoj kërkesat e parashtuara në dosje të tenderit dhe vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 duke pasur parasysh edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë dhe nenin 6 të LPP-së, ku të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e

prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si pjesërisht të bazuara, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 04.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me raportin e ekspertit të OSHP nr.957,957m994/20 dt.02.12.2020, nuk pajtohem në këto pika:

1. Pergjigje ne pretendimet te OE ankues "REXHA" SHPK

☐ **Pretendimi 1**

Ky pretendim nuk është kontestuar në vlerësimin e ofertës nga AK-ja

☐ **Pretendimi 2**

Paramasa dhe paralogaria e tregut që është zyrtarisht pjesë e dosjes së tenderit nuk e lejon shtim të pozicioneve, plotësime dhe ndryshime për shkak se është e koduar, nevojitet fjalëkalimi që e posedon vetëm AK-ja

Nuk kemi të bëjmë me përsëritje të pozicionit, por kemi të bëjmë me ndërhyrje në specifikat e tenderit duke shtuar pozicion të ri me sasi dhe çmim të ndryshëm nga specifikat e tenderit dhe në këtë rast cenohet paprekshmëria dhe siguria e dosjes së tenderit.

Shtimi i këtij pozicioni e ka bërë ofertën të pakrahasueshme me ofertat tjera. Paramasa ka qënë e koduar dhe OE qëllimisht ka ndërhyrë në të.

Konstatohet se veprimi i OE ka pasë për qëllim që të vihet në lajthitje AK-ja, komisioni i vlerësimit.

Dëshmia e ndërhyrjes

9.1	PUNET E FSADES				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1.1	Furnizimi me material dhe lyerja e fasadës si vijon: dy shtresa me ngjites, rrjeta plastike, llajsnet këndore nga i njejt prodhues etj. Në pjesën e epërme të dritareve vendoset llajsnet këndore me pikore dhe rozetat (4-5 cope/m2) per kapjen e pllakave te stiroporit. (pervec stiroporit qe nuk perfshihet ne kete pozicion), komponentet tjera te jene te prodhuesve si ne vijim: (JUB, KRAFT, RELIUS ose e ngjashme). Aplikimi i fasadës akrylike me material	m ²	310	19	5,890.00

	STO ose ekuivalenti I tyre si: (JUB, KRAFT, RELIUS ose e ngjajshme), fraksion 2 mm (ngjyra e bardhe duhet te jete e integruar ne fasade). Çmimi përfshin edhe punimin e skelës për fasadë, në tërësi sipas normave relevante.				
Total Pozicioni 9.1 :					5,890.00
1.1	Furnizimi me material dhe lyerja e fasadës si vijon: dy shtresa me ngjites, rrjeta plastike, llajset këndore nga i njejt prodhues etj. Në pjesën e epërme të dritareve vendoset llajset këndore me pikore dhe rozetat (4-5 cope/m2) per kapjen e pllakave te stiroporit. (pervec stiroporit qe nuk perfishihet ne kete pozicion), komponentet tjera te jene te prodhuesve si ne vijim: (JUB, KRAFT, RELIUS ose e ngjajshme). Aplikimi i fasadës akrylike me material STO ose ekuivalenti I tyre si: (JUB, KRAFT, RELIUS ose e ngjajshme), fraksion 2 mm (ngjyra e bardhe duhet te jete e integruar ne fasade). Çmimi përfshin edhe punimin e skelës për fasadë, në tërësi sipas normave relevante.	m ²	420	8	3,360.00
Total Pozicioni 9.1 :					3,360.00

I bashkangjitet:

1. *Deshmia që paramasa (në dosjen e tenderit zyrtarisht) është e koduar dhe nuk mundet te shtohet asnjë pozicion, plotësohet, ndryshohet.*

□ Pretendimi 3

OE në Listën e projekteve e dorëzuar dhe në plotësimin e kërkuar nuk ka përmbushë vlerën e kërkuar të projekteve(kontratave) të kryera 4,500,000.00.

Vlera e projekteve që përmbushin kërkesat e tenderit për projekte te reja te ndërtimit te larte është:

Sa i përket asaj që Ligji i ndërtimit se nuk i klasifikon si objekte te ndërtimit te larte dhe të larët, Ligji per ndërtim nr 04L-110 i trajron kryesisht ndërtimet e larta, ndërsa Ligji per rruge nr 2003/11 i trajton rrugët dhe infrastrukturën përcjellëse, AK e ka specifikuar në dosjen tenderit dhe sqarimet shtesë.

çdo ekspert i fushës se ndërtimit i dallon ndërtimet e larta nga ndërtimet e ulëta. Një përkufizim i ndarjes –llojeve te ndërtimit e gjeni ne <https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Nd%C3%ABrtimtaria>

“Objektet në ndërtimtari sipas drejtimit ndahen në: Objekte të **ndërtimit të lartë**, objekte të ndërtimit të ulët dhe objekte të ndërtimit hidro. Në ndërtimin e lartë bëjnë pjesë objektet që janë të ndërtuara në pjesën më të madhe mbi sipërfaqen e tokës .P.sh. banesa, hotele, spitale, biblioteka, qendra tregtare etj. Në **ndërtimin e ulët** bëjnë pjesë objektet e kryhen ulët për tokë,si p.sh. rrugë, hekurudha, tunele etj Në **ndërtimin hidro** bëjnë pjesë objektet që kanë të bëjnë me ujin dhe përdorimin e tij.P.sh. ura, vijadukte, rregullime lumenjesh, limane, sisteme për ujitjen dhe tharjen e tokës etj.”

Ndërsa te Ligji 2003/11 për rrugë e gjejmë definicionin e ndërtimit:

“**Ndërtimi**” e ka kuptimin e ndërtimit ose rindërtimit të rrugës dhe bërjen e ndonjë pune tjetër të domosdoshme për ta vënë rrugën në gjendje të sigurtë për shfrytëzim nga automjetet, por nuk përfshinë mirëmbajtjen;

Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit 2003/11

“**Ndërtimi**” nënkupton ndërtimin komplet të ri të rrugës dhe të objekteve të tjera përcjellëse të rrugës; Në përkufizim dhe në tërë tekstin e ligjit fjala “Autostradë” zëvendësohet me fjalën “Autoudhë”.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ndërtimit të reja, (ndërtim i lartë) në vlerë minimale prej 7,500,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrat (në rast konzorciumi udhëheqës i konzorciumit duhet të plotësoj të paktën 60% të kërkesës).

- Ju keni kërkuar që të jenë kontratat në fushën e ndërtimit (ndërtim të lartë) kurse natyra e punës është ndërtim i ulët, ju lutem na e sqaroni a pranohen kontratat e ndërtimit të ulta si sheshe,rrugë etj?

“Natyra e punës është e ndërtimit të lartë prandaj ju njoftojmë se nuk pranohen kontratat e ndërtimit të ulte.”

I bashkangjitet:

1. Rexha –kërkese për sqarime shtese
2. Sqarime shtese për OE në dosjen e tenderit me datë 31.01.2020
3. Sqarimet e menaxhereve të projekteve nga lista e bashkangjitur e EO Rexha SHPK, ku konfirmohet se punët në këto projekte janë punë të sanimeve dhe të ndërtimit të ulët dhe në kundërshtim me sqarimet e dhëna në dosjen e tenderit.

☐ Pretendimi 4

Lidhur me këtë pretendim kemi mendimin e ekspertit të OSHP PSH nr 388/20 390/20 ku i njëjti këtë pretendim të OE e vlerëson si pretendim të pa bazuar.

Lidhur me këtë pretendim të OE “Rexha” shpk , konstatojmë se është tërësisht i pa bazuar , kjo dëshmohet nga OE “Fidolla” me dëshmi, qarkullim bankar dhe dokumentet tjera përcjellëse , letër konfirmim dhe letër sqarim (të gjitha materialet e dëshmive do t’i keni të bashkangjitura kësaj shkrese)

I bashkangjitet:

4. Dëshmitë e situacioneve, pagesave.

Dokumentet 01.02.03.04.05.06.07.08.09.10.11.12.13.14.15.16.17.18.19.20., Dok1

Pagesat Mabco, Medica si dhe situacionet.

☐ Pretendimi 5

Lidhur me këtë pretendim kemi mendimin e ekspertit të OSHP PSH nr 388/20 390/20 ku i njëjti këtë pretendim të OE e vlerëson si pretendim të pa bazuar.

Citojmë "OE i rekomanduar për kontratë, certifikatat ISO i ka ofruar në origjinal. Dokumenti në origjinal është me i besueshëm edhe juridikisht se sa kopja e atij dokumenti e noterizuara. Qëllimi i kërkesës së DT është që OE të posedoj certifikatat dhe kërkesa për Noterizimi është nëse të njëjtat ofrohen si kopje .Kjo këtë kuptim ka .Përndryshe ofrimi i dokumentit në origjinal e arrin efektin për të cilin është kërkuar. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të pabazuar.

Edhe në këtë pretendim të OE "Rexha" shpik e vlerësojmë si tërësisht të pa bazuar pasi OE "Fidolla" ka dorëzuar certifikatat ISO në origjinal dhe në kërkesën për plotësim ka sjellë edhe ato të noterizuara.

☐ Pretendimi 6

Lidhur me këtë pretendim ne mendojmë që është i pa bazuar pasi që OE në pas kërkesën nga AK për sqarime plotësim të dëshmive , ka sjellë dëshmi të autoriteti kontraktues se posedon vinçin në emër të "Fidola" dhe është pronar i vinçit.

I bashkangjitet:

5. Dëshmitë e Veqit, dokumenti pika 8 Vinqi

☐ Pretendimi 7

Edhe për këtë pretendim të OE ,ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit sepse:

Nga harmoni me LPP dhe RROUPP të qenit "ne pajtueshmëri nga aspekti administrativ dhe teknik të parashtruar në dosje të tenderit duke mos u larguar substancialisht nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime. Pra nga ky përkufizim ligjor lejohet devijimi që nuk janë substancialisht si në rastin konkret.

Ky devijim është i vogël dhe i papërfillshëm për aktivitetin konkret.

2. Përgjigje në pretendimet të OE ankues "PE-VL-KU" SHPK

☐ Pretendimi 2

Lidhur me këtë pretendim kemi mendimin e ekspertit të OSHP PSH nr 388/20 390/20 ku i njëjti këtë pretendim të OE e vlerëson si pretendim të pa bazuar.

Citojmë "OE i rekomanduar për kontratë, certifikatat ISO i ka ofruar në origjinal. Dokumenti në origjinal është me i besueshëm edhe juridikisht se sa kopja e atij dokumenti e noterizuara. Qëllimi i kërkesës së DT

është që OE të posedoj certifikatat dhe kërkesa për Noterizimi është nëse të njëjtat ofrohen si kopje .Kjo këtë kuptim ka .Përndryshe ofrimi i dokumentit në origjinal e arrin efektin për të cilin është kërkuar. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të pabazuar.

Edhe në këtë pretendim të OE **“PE-VL-KU”** sikurse edhe të OE **“Rexha”** shpk e vlerësojmë si tërësisht të pa bazuar pasi OE **“Fidolla”** ka dorëzuar certifikatat ISO në origjinal dhe në kërkesën për plotësim ka sjelle edhe ato të noterizuara.

□ Pretendimi 5

Lidhur me këtë pretendim kemi mendimin e ekspertit të OSHP PSH nr 388/20 390/20 ku i njëjti këtë pretendim të OE e vlerëson si pretendim të pa bazuar.

Lidhur me këtë pretendim të OE **“Rexha”** shpk ashtu edhe të OE **“PE-VL-KU”** , konstatojmë se është tërësisht i pa bazuar , kjo dëshmohet nga OE **“Fidolla”** me dëshmi, qarkullim bankar dhe dokumentet tjera përcjellëse , letër konfirmim dhe letër sqarim (të gjitha materialet e dëshmive do ti keni të bashkangjitura kësaj shkrese)

I bashkangjitet:

6. Dëshmitë e situacioneve, pagesave.

Dokumentet 01.02.03.04.05.06.07.08.09.10.11.12.13.14.15.16.17.18.19.20., Dok1

Pagesat Mabco, Medica si dhe situacionet.

3. Përgjigje në pretendimet të OE ankues **“RAF II”SHPK**

Operatori ekonomik **“RAF II”SHPK** nuk e ka konfirmuar sigurimin dhe vlefshmërinë e ofertave, konsiderohet OE i pa përgjegjshëm dhe nuk është më palë e interesit sipas Nenit 4.1.26.

From: Fatmir.R.Uka <fatmir.r.uka@rks-gov.net>

Sent: Friday, December 4, 2020 12:41 PM

To: Ferit Fazliu <Ferit.Fazliu@rks-gov.net>; Halil Fejziu <Halil.Fejziu@rks-gov.net>

Subject: RE: Informime

I nderuar,

Në lidhje me kërkesën e juaj,për projektin,,Sanimi i **dyshemesë urbane të Sheshit "Adem Jashari"** në bazë të vlerësimeve të mia në cilësinë e Menaxherit të kësaj kontrate ,ju përcjell sqarimet si në vijim:

- sipas Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 ky projekt hynë me përkufizimin,,Ndërtim peisazhi"(neni 1.14), nuk hynë në përkufizimin e „**Ndërtimit të ri**" meqenëse nuk e zavendëson plotësisht ndërtimin e ri ,si dhe sipas të dhënave studimore-literaturës ky projekt i takon „**Ndërtimit të Ultë**".

From: Halil Fejziu <Halil.Fejziu@rks-gov.net>

Sent: Friday, December 4, 2020 11:46 AM

To: Ferit Fazliu <Ferit.Fazliu@rks-gov.net>; Fatmir.R.Uka <fatmir.r.uka@rks-gov.net>

Subject: RE: Informime

Përshendetje:

I nderuar duke u nisur nga pyetja e juaj për sqarim, si komision që kemi bërë vlerësimin e punimeve në "bulevardin mbi kurriz" ju njoftoj se këto punime janë rikonstruim, nuk janë ndërtim i ri dhe i përkasin ndërtimit të ulët.

Me respekt:

Halil Fejziu

Zyrtar i lartë për ndërtim urban

Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të kontratave

Komuna e Prishtinës

e-mail: halil.fejziu@rks-gov.net

tel: 038 230-900 lok.1168

mob: +377 44 112-327

From: Ferit Fazliu <Ferit.Fazliu@rks-gov.net>

Sent: Friday, December 4, 2020 10:02 AM

To: Halil Fejziu <Halil.Fejziu@rks-gov.net>; Fatmir.R.Uka <fatmir.r.uka@rks-gov.net>

Subject: Informime

Përshëndetje,

Kërkoj nga ju si menaxher të kontratës të me sqaroni lidhur me këto kontrata :

1. Ndërtimi i bulevardit mbi kurriz dhe
2. Sanimi i dyshemesë urbane të sheshit Adem Jashari

Këto kontrata a janë kontrata të ndërtimit të lartë dhe të njëjtat a janë ndërtim i ri

Me respekt,

Ferit Fazliu,

Msc-inxh i dipl. i ndërtimtarisë

MA-Master i arteve në administrim biznesi

Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Larta

Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

Komuna e Prishtinës

RECAPITULATION											
	BILL OF QUANTITIES(BoQ) -		Previous		IPC - No.1		Total Executed		Remaining for		Remarks
	Description	Amount	Quantity	Amount	Quantity	Amount	Quantity	Amount	Quantity	Amount	
		EUR	%	EUR	%	EUR	%	EUR	%	EUR	
0	Preambles										

1	Preliminaries &	85,136.23 €	0.00%	0.00 €	8.41	7,163.36	8.41	7,163.3	91.5	77,972.8	
I	Architectural &	3,265,256.2	0.00%	0.00 €	2.02	65,958.1	2.02	65,958.	97.9	3,199,29	
II	Electrical VVorks	1,163,592.7	0.00%	0.00 €	0.00	0.00 €	0.00	0.00 €	100.	1,163,59	
III	Mechanical VVorks	1,275,356.7	0.00%	0.00 €	0.00	0.00 €	0.00	0.00 €	100.	1,275,35	
IV	VVater & Sečerage	860,638.32	0.00%	0.00 €	0.00	0.00 €	0.00	0.00 €	100.	860,638.	
TOTAL		6,649,980.2	0.00%	0.00 €	1.10	73,121.5	1.10	73,121.	98.9	6,576,85	

Operatori Ekonomik, "Pe-vla-ku" me datë: 04.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE "Rexha" Shpk, se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesën mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të parashtruar në dosje të tenderit ku është kërkuar qarkullimi financiar për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 10,000,000.00 € (në rast konzorciumi lideri duhet ti plotësoj 60 % të kërkesës), që sipas OE ankues dëshmitë e ofruara e përmbushin vlerën e kërkuar.

Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar edhe në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020, në të cilin vendim është udhëzuar AK që të kërkoj sqarime lidhur me qarkullimin financiar. OE ankues "Rexha" Shpk ka dorëzuar deklaratën e qarkullimit financiar të ATK-së për vitin 2017 në vlerë prej 1,764,217.31€, deklaratën e ATK-së për vitin 2018 në vlerë prej 1,036,771.63, ndërsa për vitin 2019 ka dorëzuar një letër konfirmim të bankës Raiffesien Bank sipas të cilës qarkullimi i OE "Rexha" Shpk për vitin 2019 ka qenë 2,623,087.23€. Gjithashtu ka dorëzuar edhe një konfirmim të bankës TEB sipas të cilës ka pasur një qarkullim 1,037,438.00 €. Paneli Shqyrtues konstaton se dëshmitë e ofruara nga OE ankues bazuar edhe në kërkesën për sqarime nga AK e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE "Rexha" Shpk, se AK ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se në paramasë të objektit 3, pozicioni 9.1 është përsëritur dy herë, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim

është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit ky ndryshim duhet të trajtohet si gabim aritmetik që nuk kalon vlerën prej 2% të totalit të ofertës. OE ankues në njërin pozicion ka paraqitur sasi të që i ka paraparë AK-ja, ndërsa në pozicionin vijues ka paraqitur një sasi të gabuar dhe AK është dashur të kërkoj sqarim apo edhe të mos kërkohet fare sqarim, por vetëm të zbritet pozicioni me gabime dhe për këtë të njoftohet tenderuesi. Pretendimi ankimor është i bazuar

Lidhur me pretendimin e OE “Rexha” Shpk, se oferta e tyre është eliminuar me arsyetimin se nuk ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontrata të ngjashme siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së duhet të kërkoj sqarime shtesë dhe ti sqaroj kontratat e OE ankues se a e plotësojnë këtë kërkesë të AK-së. Në bazë të vendimit të OSHP-së, AK me datë 25.09.2020 përmes letrës standarde për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarime nga OE “Rexha” Shpk, duke kërkuar sqarime lidhur me atë se në çka bazon pretendimin e tyre për eliminim pa të drejtë lidhur me referencat të cilat janë trajtuar nga AK sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Kurse, OE ankues “Rexha” Shpk në përgjigjen e tij ka dorëzuar një listë të kontratave të realizuara së bashku me referencat për realizimin e këtyre kontratave që tejkalojnë vlerën e kërkuar prej 4,500,000.00 €. Në pyetjen e një OE drejtuar AK-së për sqarime “Pasi që edhe renovimet e objekteve hyjnë në kategorinë e ndërtimit të lartë, atëherë a mund të na tregoni se a njihen si referenca eksperiencia e punës në renovimin e objekteve të lartë?”, AK me datë 31.01.2020 jep këtë përgjigje/sqarim “Nuk pranohen eksperiencia e punës së renovimeve por pranohen referencat e ndërtimeve të larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit të nenit 3 paragrafi 1.10 të ligjit për nderim NR.04 L-110).

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh kërkesën e AK-së në dosje të tenderit e cila ka qenë:

“1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ndërtimeve të reja, **(ndërtim i lartë)** në vlerë minimale prej 7,500,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrata (në rast konzorciumi udhëheqësi i konzorciumit duhet të plotësojë të paktën 60% të kërkesës).”, sqaron se OE ankues ka bashkangjitur listat e projektveve të të gjithë anëtarëve të konzorciumit, por nëse e marrim vetëm listën e Liderit ka dorëzuar deri në vitin 2018 listën prej 7,713,937.01€ ndërsa për vitin 2019 ka bashkangjitur listën prej 3,528,758.20 € dhe AK për më tepër duhet të shikoj pozicione të njëjta a ka të kryera brenda periudhës së kërkuar pasi që siç shihet nga lista e plotëson kërkesën e AK-se, pra ky pretendim ankimor i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues “Rexha” Shpk, se autoriteti kontraktues ka pranuar referencën e OE të rekomanduar për kontratë lidhur me projektin “Ndërtimi i spitalit pediatrik dhe Kirurgjisë

Pediatrike, QKU” edhe pse kjo referencë nuk është nga AK shtetëror (QKUK) por është nga një OE privat. Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20, ku është konstatuar: “Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se projektin në fjalë, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka të kontraktuar nga QKUK por ka të kontraktuar nga një kompani private. Shprehja apo përkufizimi “Autoritet kontraktues” nuk nënkupton vetëm autoritetet publike apo shtetërore. Sipas nenit 4 pika 1.14 të LPP-së Autoritet kontraktues është edhe kompania private. Prandaj çdo projekt i kryer nga një OE me një kompani private për të cilin merr edhe referencën e njëjta referencë është e pranueshme sipas ligjit të prokurimit. Edhe në rastin konkret referenca e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për projektin e kryer në ndërtimin e spitalit në fjalë është e pranueshme dhe si e tillë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Në kuptim të kësaj që u sqarua, ky pretendim ankimor është i pa bazuar”.

Përveç konstatimit paraprak nga Paneli Shqyrtues në lidhje me këtë pretendim, edhe tani Paneli Shqyrtues sqaron se çdo punë, shërbim apo furnizim që ndodh dhe dëshmohet me dokumente (kontrata, pranime teknike, procesverbale, etj.) dhe puna, shërbimi apo furnizimi është deklaruar pranë ATK-së apo në rastin e ndërtimit të objekteve është pranuar nga komuna apo ministria, duhet të pranohet sepse nuk ka kurrfarë vlere më të madhe apo më të vogël një kontratë apo referencë e lëshuar nga një autoritet publik përderisa nuk kontestohet kontrata e lëshuar nga një subjekt privat. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues “Rexha” Shpk, se OE i rekomanduar për kontratë certifikatat për ISO STANDARDE nuk i ka ofruar të noterizuara siç është kërkuar në dosje të tenderit. Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit është kërkuar që AK gjatë rivlerësimit të kërkoj konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së informata shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë më saktësisht certifikatat ashtu siç ka qenë kërkesë e vet AK-së. Konform vendimit të OSHP-së, AK me datë 25.09.2020 përmes “Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit” ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzoj certifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit. Në lidhje me këtë, OE “Fidolla” ka dorëzuar certifikatat ISO në origjinal dhe në kërkesën për plotësim ka sjelle edhe ato të noterizuara.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Rexha” Shpk, se AK ka shpërblyer me kontratë OE i cili nuk ka dorëzuar dëshmitë për pajisjet siç është kërkuar në dosje të tenderit, konkretisht nuk ka dorëzuar listën e pajisjeve dhe dëshminë për vinç dhe sipas OE ankues kjo ofertë duhej të shpallej e papërgjegjshme.

Paneli Shqyrtues sqaron se pas kërkesës nga AK për sqarime, plotësim të dëshmimeve OE kishte dorëzuar dëshmi te autoriteti kontraktues se posedon vinçin në emër të “Fidola” dhe është pronar i vinqit, ku AK ka bashkangjitur dëshmitë e Vinqit, dokumenti pika 8 Vinqi.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Rexha" Shpk se Inxhinieri i Elektroteknikës-drejtimi energjetik i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse inxhinieri është i diplomuar me datë 08.12.2015 dhe nuk plotëson përvojën prej 5 vitesh siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Paneli Shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojë dëshmi për inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku 2 kontrata të natyrës së ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me CV, Diplomë, Kontratë të punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).

Për këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një diplomë të z. Behar Zeqiri, i dipl në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 23.11.2015 si Master i shkencave të Inxhinierisë elektrike, që bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit nuk e plotëson përvojën prej 5 vitesh. Kurse, në vendimin e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE ankues "Rexha" Shpk ky pretendim është trajtuar si devijim i vogël. Duke pasur parasysh kërkesën decitive të AK-së, Paneli Shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Rexha" Shpk se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar deklaratat për listën e punëtorëve të punësuar konform dosjes së tenderit, ku është kërkuar që OE duhet të ketë mesataren e punëtorëve të punësuar minimum 100 punëtor për vitin 2017, 2018 dhe 2019.

Paneli Shqyrtues sqaron se konzorciumi OE "Fidola" & "Nartel Exin" Shpk ka dorëzuar listat për të dy anëtarët e konzorciumit. OE "Fidola" ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së për tri vitet, ndërsa anëtari tjetër i konzorciumit "Nartel Exin" Shpk ka dorëzuar deklaratat e listave të punëtorëve të vulosura për tri vitet. Deklaratat e dorëzuara për listat e punëtorëve të punësuar janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse në dosje është kërkuar deklaratë dhe nuk është specifikuar që duhet të jetën vetëm dëshmia e ATK-së. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "PE-VLA-KU" SHPK.

Lidhur me pretendimin e OE "PE-VLA-KU" SHPK, se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka rekomanduar për kontrate përsëri ofertën e grupit të OE "Fidola" & "Nartel Exin" Shpk edhe pse marrëveshja e konzorciumit e dorëzuar nga grupi i OE nuk është e kompletuar dhe mungojnë të dhënat e tenderit, si dhe deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit "Nartel Exin" Shpk është pa datë.

Paneli Shqyrtues sqaron se marrëveshja e konzorciumit të grupit të OE "Fidola" & "Nartel Exin" Shpk është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe në fund të marrëveshjes të dy anëtarët e konzorciumit kanë dorëzuar autorizimet e nënshkruara dhe të vulosura ku është specifikuar edhe nr. i prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit. Sa i përket pretendimit të OE ankues se deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit "Nartel Exin" Shpk është pa datë, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është i pa bazuar sepse deklarata nën betim e dorëzuar nga anëtari i konzorciumit "Nartel Exin" Shpk është e vulosur dhe e nënshkruar, si dhe i drejtohet autoritetit kontraktues "Komuna e Prishtinës" dhe mungesa e datës nuk paraqet ndonjë shkelje domethënëse. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "PE-VLA-KU" SHPK, se OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar deklarate të specifikacioneve teknike konform nenit 28 të LPP-së, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është i pa bazuar sepse në dosje të tenderit nuk është kërkuar deklarata e specifikacioneve teknike.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "PE-VLA-KU" SHPK, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të gjitha certifikatat ISO siç janë kërkuar në dosje të tenderit dhe sipas OE ankues edhe pas kërkesës për sqarim nga AK, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar certifikatat OHSAS 18001 2007, ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012.

Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit është kërkuar që AK gjatë rivlerësimit të kërkoj konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së informata shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë më saktësisht certifikatat ashtu siç ka qenë kërkesë e vet AK-së. Konform vendimit të OSHP-së, AK me datë 25.09.2020 përmes "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit" ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzoj certifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit. Në lidhje me këtë, OE "Fidolla" ka dorëzuar certifikatat ISO në origjinal dhe në kërkesën për plotësim ka sjelle edhe ato të noterizuara.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se mungojnë certifikatat OHSAS 18001 2007, ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012, Paneli Shqyrtues sqaron se dy certifikatat ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012 janë larguar si kërkesa të dosjes së tenderit në "NJOFTIM PËR INFORMATA SHITESË ose PËRMIRËSIM I GABIMIT", ndërsa për certifikatën OHSAS 18001 2007 OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatën ISO 45001-20018 më të avancuar e cila është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20. Pretendimi ankimor është është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PE-VLA-KU" SHPK, se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën e gjendjes ekonomike dhe financiare të dosjes së tenderit ku është kërkuar që

qarkullimi financiar për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 10,000,000.00 € (në rast konzorciumi lideri duhet ti plotësoj 60 % të kërkesës).

Paneli Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë, konkretisht lideri i konzorciumit “Fidola” ka dorëzuar deklaratën e qarkullimit financiar të ATK-së për vitin 2017 në vlerë prej 575,240.56€, deklaratën e ATK-së për vitin 2018 në vlerë prej 1,287,630.13 €, ndërsa për vitin 2019 ka dorëzuar një deklaratë të bankës Raiffesien Bank sipas të cilës qarkullimi i OE “Fidola”për vitin 2019 ka qenë 4,417,286.86 €. Ndërsa për anëtarin tjetër të konzorciumit “Nartel Exin”Shpk ka dorëzuar deklaratën e ATK-së për vitin 2017 në vlerë 1,841,999.70 €,për vitin 2018 vlerën prej 1,647,393.61 €,ndërsa për vitin 2019 kanë dorëzuar një pasqyrë të të ardhurave të “Nartel Exin”Shpk me shumën hyrëse për vitin 2019 në vlerë prej 1,456,295.74 €. Pra, Paneli Shqyrtues konstaton se dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “PE-VLA-KU” SHPK, se Inxhinieri i Makinerisë i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është konform dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë një inxhinier të diplomuar të makinerisë (termoenergjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata të natyrës se ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me diplomë, kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, referenca per Inxhinier i dip. i makinerise (termoenergjetike). Ndërsa, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar diplomën e z. Aziz Llugiqi i diplomuar në Fakultetin Teknik të Prishtinës në vitin 1980. Paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin se OE të rekomanduar për kontratë i mungon kontrata për inxhinierin e hidroteknikës, Paneli Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar diplomën dhe kontratën e punës për inxhinierin e Hidroteknikës z.Bujar Gashi, andaj ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “PE-VLA-KU” SHPK, se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme duke potencuar disa referenca të cilat sipas OE ankues nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues për këtë pretendim sqaron se vetëm referenca e lëshuar nga “Mabetex Group” për OE e rekomanduar për kontratë për punët e kryera në Spitalin Pediatrik dhe Kirurgji Pediatrike në QKUK, e plotëson këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Po ashtu, referencat e lëshuara nga Kompania Dugagjini dhe Trade Center Prishtina tejkalojnë shumën prej 4,500,000.00 euro. Sa i përket çështjes së referencat e lëshuara nga bizneset private, Paneli Shqyrtues sqaron se edhe në vendimin PSH.nr.388-390/20 është

konstatuar:

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se projektin në fjalë, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka të kontraktuar nga QKUK por ka të kontraktuar nga një kompani private. Shprehja apo përkufizimi “Autoritet kontraktues” nuk nënkupton vetëm autoritetet publike apo shtetërore. Sipas nenit 4 pika 1.14 të LPP-së Autoritet kontraktues është edhe kompania private. Prandaj çdo projekt i kryer nga një OE me një kompani private për të cilin merr edhe referencën e njëjta referencë është e pranueshme sipas ligjit të prokurimit. Edhe në rastin konkret referenca e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për projektin e kryer në ndërtimin e spitalit në fjalë është e pranueshme dhe si e tillë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Në kuptim të kësaj që u sqarua, ky pretendim ankimor është i pa bazuar”.

Përveç konstatimit në vendimin paraparak nga Paneli Shqyrtues në lidhje me këtë pretendim, edhe tani Paneli Shqyrtues sqaron se çdo punë, shërbim apo furnizim që ndodh dhe dëshmohet me dokumente (kontrata, pranime teknike, procesverbale, etj.) dhe puna, shërbimi apo furnizimi është deklaruar pranë ATK-së apo në rastin e ndërtimit të objekteve është pranuar nga komuna apo ministria, duhet të pranohet sepse nuk ka kurrfarë vlere më të madhe apo më të vogël një kontratë apo referencë e lëshuar nga një autoritet publik përderisa nuk kontestohet kontrata e lëshuar nga një subjekt privat. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “PE-VLA-KU” SHPK, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar listën e makinerive siç është kërkuar në dosje të tenderit, Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi lidhur me makineritë është pak a shumë i ngjashëm dhe është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20, ku në këtë vendim është konstatuar “Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje të tenderit për këtë pikë nuk ka qenë decidivisht që pajisjet, respektivisht kamionët duhet të janë të regjistruar. Por për pajisje janë kërkuar dëshmi si deklarata unike doganore ose kontrata për faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar si dëshmi librezat e kamionëve si dëshmi që i posedojnë këta kamion. Regjistrimi i automjetit mundet të bëhet varësisht prej nevojave të kompanisë. I duhet një kamion i tillë për transport apo nuk i duhet. E rëndësishëm për këtë pikë të dosjes së tenderit është që OE ti posedojnë këto pajisje, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar”. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “PE-VLA-KU” SHPK, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar deklaratat për listën e punëtorëve të punësuar konform dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të ketë mesataren e punëtorëve të punësuar minimum 100 punëtor për vitin 2017,2018 dhe 2019, Paneli Shqyrtues sqaron se konzorciumi “OE “Fidola” & “Nartel Exin” Shpk ka dorëzuar listat për të dy

anëtarët e konzorciumit. OE "Fidola" ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së për tri vitet, ndërsa anëtari tjetër i konzorciumit "Nartel Exin" Shpk ka dorëzuar deklaratat e listave të punëtorëve të vulosura për tri vitet. Deklaratat e dorëzuara për listat e punëtorëve të punësuar janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse në dosje është kërkuar deklaratë dhe nuk është specifikuar që duhet të jetë vetëm nga dëshmia e ATK-së. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "PE-VLA-KU" SHPK, se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar marrëveshjet për gurëthyes dhe beton të cilat nuk janë të nënshkruara dhe vulosura. Paneli Shqyrtues konform sqaron se ky pretendim është pranuar edhe nga AK në vendimin e tyre ndaj kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga OE ankues. Lidhur me këtë, Paneli Sqaron se dy marrëveshjet për gurëthyes dhe beton të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë janë të nënshkruara dhe vulosura nga ana e furnitorit ku janë të bashkangjitura edhe "Lejet për aktivitete të veqanta "(Liçencat) për të dy furnitorët, ndërsa me kërkesë të AK-së, marrëveshjet janë të nënshkruara edhe nga blerësi në këtë rast nga OE "Fidola".

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Raf II" Shpk, se Inxhinieri i Elektroteknikës-drejtimi energjetikë i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse inxhinieri është i diplomuar me datë 08.10.2015 dhe nuk plotëson përvojën prej 5 vitesh siç është kërkuar në dosje të tenderit. Paneli Shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë dëshmi për inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku 2 kontrata të natyrës së ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me CV, Diplomë, Kontratë të punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).

Për këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një diplomë të z. Behar Zeqiri, i dipl në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 23.11.2015 si Master i shkencave të Inxhinierisë elektrike, që bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit nuk e plotëson përvojën prej 5 vitesh. Kurse, në vendimin e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE ankues "Rexha" Shpk ky pretendim është trajtuar si devijim i vogël. Duke pasur parasysh kërkesën decidive të AK-së, Paneli Shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Raf II" Shpk, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të gjitha certifikatat ISO siç janë kërkuar në dosje të tenderit dhe sipas OE ankues, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar certifikatat OHSAS 18001 2007,ISO 27001 2013,eksperti

shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar edhe në vendimin e panelit PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020.

Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit është kërkuar që AK gjatë rivlerësimit të kërkojë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së informata shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë më saktësisht certifikatat ashtu siç ka qenë kërkesë e vet AK-së. Konform vendimit të OSHP-së, AK me datë 25.09.2020 përmes “Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit” ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzojë certifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit. Në lidhje me këtë, OE “Fidolla” ka dorëzuar certifikatat ISO në origjinal dhe në kërkesën për plotësim ka sjelle edhe ato të noterizuara.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se mungojnë certifikatat OHSAS 18001 2007, ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012, Paneli Shqyrtues sqaron se dy certifikatat ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012 janë larguar si kërkesa të dosjes së tenderit në “NJOFTIM PËR INFORMATA SHITESË ose PËRMIRËSIM I GABIMIT”, ndërsa për certifikatën OHSAS 18001 2007 OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatën ISO 45001-20018 më të avancuar e cila është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Raf II” Shpk, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar listën e makinerive siç është kërkuar në dosje të tenderit. Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi lidhur me makineritë është pak a shumë i ngjashëm dhe është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20, ku është konstatuar: “Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje të tenderit për këtë pikë nuk ka qenë decidivisht që pajisjet, respektivisht kamionët duhet të janë të regjistruar. Por për pajisje janë kërkuar dëshmi si deklarata unike doganore ose kontrata për faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar si dëshmi librezat e kamionëve si dëshmi që i posedojnë këta kamion. Regjistrimi i automjetit mundet të bëhet varësisht prej nevojave të kompanisë. I duhet një kamion i tillë për transport apo nuk i duhet. E rëndësishëm për këtë pikë të dosjes së tenderit është që OE ti posedojnë këto pajisje, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar”. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtoje aktiviteti të prokurimit, pas shqyrtimit të shkresave të lëdnës dhe pretendimeve ankimore, konstaton se AK nuk ka rivlerësuar tenderët konform dispozitave ligjore dhe kërkesave të dosjes së tenderit. Andaj, obligohet AK që të bëjë rivlerësimin e ofertave duke respektuar kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit dhe nenit 59 të LPP-së, si dhe vendimet e OSHP-së. Njëkohësisht, AK duhet të ketë parasysh edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është

të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Po ashtu, AK të ketë parasysh edhe nenin 6 të LPP-së, ku të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK PRISHTINË"
- 1x1 OE "REXHA" SHPK;
- 1x1 OE "PE-VLA-KU" SHPK;
- 1x1 OE "RAF II" SHPK;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.